

KËRKESË PËR INFORMACION

PYETJE/PERGJIGJE

Pyetja nr 1: Sa është numri i pacienteve që marrin aktualisht shërbimin e dializës në vendin tonë.

Përgjigje: Numri i pacientëve që kanë përfituar paketën e dializës, të ofruar në institucionet shëndetësore të financuara nga Fondi për muajin Mars 2025, është 1477 pacientë.

Pyetja nr 2: Sa pacientë marrin shërbim në spitalet publike dhe në spitalet private?

Përgjigje: Numri i pacientëve të dializës që marrin shërbim sipas institucioneve shëndetësore publike/jopublike dhe forma PPP është:

- Spitale publike-----108 pacientë
- Spitale jopublike-----874 pacientë
- Koncesionari(PPP)-----495 pacientë

Pyetja nr 3: Si është i shpërndarë numri i pacientëve që kryejnë dializë sipas Rajoneve?

Përgjigje: Numri i pacientëve që kryejnë dializë sipas Rajoneve, është si më poshtë:

Nr	Spitalet	Nr pacienteve
1	Shkodër	88
2	Lezhë	73
3	Vlorë	66
4	Elbasan	149
5	Korçë	119
6	Fier	118
7	Gjirokastrë	55
8	Berat	73
9	Durrës	139
10	Tiranë	597
	Totali	1,477

Pyetja nr 4: Sa është numri i pacienteve të regjistruar që presin të kryejnë transplantin e veshkave?

Përgjigje: Numri i pacientëve të regjistruar që kërkojnë transplant administrohet e vlerësohet nga shërbimi shëndetësor i nefrologji- dializës në QSUT mbi bazën e informacionit shëndetësor që

kanë për çdo pacient, si dhe varet së pari nga gjetja e donatorit për dhurimin e veshkës, plotësimi i kriterëve dhe kushteve që kërkohet sipas protokollit mjekësor përkatës për mundësinë e realizimit të transplantit dhe funksionalitetit të veshkës.

Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës (me dhurues të gjallë) përfshihen:

Paketa e shërbimit të transplantit të veshkës
Në këtë paketë përfshihen:
Ekzaminimet para transplantit për marrësin e dhuruesin:
- klinikë biokimike;
- imunologjike;
- markuesit tumoralë;
- imazheri virologjike;
Konsultat;
operacioni dhe ndjekja;
ekzaminimet pas transplantit për marrësin e dhuruesin;
terapia e induksionit;
imunosupresoret (dozimi në gjak).

Pyetja nr. 5: Sa ishte buxheti i planifikuar për kryerjen e transplantit për vitin 2024?

Përgjigje. Paketa e transplantit të veshkës paguhet sipas mënyres Pay per Use, paguhet sa transplante realizohen pasi është gjetur donatori i veshkës, si dhe janë plotësuar kriteret mjekësore të përcaktuara sipas protokollit mjekësor.

Çmimi për Paketën Transplantit të veshkës është në vlerën 1,151,942 lekë. (miratuar me VKM Nr 102 datë 05.02.2020)

Pyetja 6: Sa ishte numri i pacientëve të planifikuar për të kryer transplantin e veshkës dhe sa kanë kryer transplantin me mbulim të plotë nga buxheti i shtetit sipas grup moshës e gjinisë për vitin 2024?

Përgjigje: Në vitin 2024 nga Fondi janë financuar të gjithë pacientet që plotësonin kriteret mjekësore sipas protokollit mjekësor për të kryer transplantin. Në vitin 2024 janë realizuar në spitalet e kontraktuara nga Fondi dhe financuar 14 Paketa të Transplantit të Veshkës.

Pyetja 7: Sa është numri i pacienteve të planifikuar dhe buxheti i planifikuar për kryerjen e transplantit të veshkave për vitin 2025?

Përgjigje. Siç e trajtuam edhe te pyetja nr 5, Fondi mbulon me buxhet te gjitha transplantet e veshkave te pacienteve qe do të kryhen 2025, nëse janë gjetur donatorët e veshkes (dhurues te gjalle) si dhe nëse plotesohen kriteret mjekesore të percaktuara që kerkohen per transplant veshke.